



Propozimet e FLOSSK për Qeverinë në lidhje me politikat Open Source

Mars 2021

Përgatitur nga anëtarët dhe miqtë e FLOSSK-ut

PËRMBAJTJA

03

Veprimi 1 - Krijimi i një politike që përcakton dhe zgjeron materialin publik të krijuar nga institucionet nën domenin publik

04

Veprimi 2 - Prokurimi i softuerit të lirë dhe me kod burimor të hapur

05

Veprimi 3 - Hapja e softuerit të ndërtuar për institucionet publike dhe publikimi në një repozitor publik

06

Veprimi 4 - Publikimi i të dhënave të krijuara nga institucionet publike si të dhëna të hapura

07

Veprimi 5 - Blerja e të drejtave të librave shkollorë dhe botimi nën një licencë të hapur

08

Veprimi 6 - Adoptimi i një shpërndarje falas të Sistemit Operativ për shkollat, përfshirja e alternativave të Softuerit të Lirë në kurrikulë dhe adoptimit i përgjeve të Softuerit të Lirë në administratën publike

09

Veprimi 7 - Politikat FLOSS

10

Për FLOSSK-un

Veprimi 1

Krijimi i një politike që përcakton dhe zgjeron materialin publik të krijuar nga institucionet nën domenin publik

Situata aktuale

Sipas ligjit, të gjitha veprat kreative të krijuara në Kosovë, përveç nëse thuhet ndryshe, bien nën mbrojtjen e së drejtës së autorit. Sidoqoftë, neni 12 i Ligjit mbi të Drejtat e Autorit rendit disa vepra të përjashtuara nga kjo rregull nëse ato krijohen nga administrata publike.

Ndryshimi i propozuar

Përcaktimi i një politike që vë më shumë, nëse jo të gjitha veprat e administratës publike ose të financuar nga paraja publike, në domenin publik dhe ky njoftim i domenit publik bëhet i qartë në të gjithë veprat e tilla, duke filluar me faqet e internetit të institucioneve publike.

Arsyetimi dhe ndikimi i pritshëm

Veprat e krijuara përmes buxhetit publik veç paguhen një herë nga publiku përmes taksave, prandaj duhet t'i kthehen publikut përmes një politike të domenit publik.

Termat e së drejtës së autorit siç praktikohen aktualisht janë ekstreme pasi skadojnë 70 vjet pas vdekjes së autorit dhe nuk kontribuojnë në krijimin e veprave të reja, në të njëjtën kohë pengojnë ndarjen dhe krijimtarinë kulturore dhe arsimimin që ndërtohet mbi veprat ekzistuese. Ne presim që kjo politikë të vërë në dispozicion të publikut të gjerë më shumë material kulturor të krijuar nga administrata publike dhe të nxisë aktivitetin ekonomik.

Kostoja dhe afati kohor

Kosto minimale administrative për të miratuar dhe informuar të gjitha nivelet e administratës për politikën. Nuk ka ndonjë kosto oportune për qeverinë.

Veprimi 2**Prokurimi i softuerit të lirë dhe me kod burimor të hapur****Situata aktuale**

Kosova ka mungesë të ofrimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike si për qytetarët ashtu edhe për vetë administratën publike. Projektet e softuerit janë të kushtueshme, janë domiuar nga disa firma të afërta me partitë politike në pushtet dhe janë me cilësi të ulët.

Ndryshimi i propozuar

Qeveria do të miratojë një politikë e cila duhet të çojë në adoptimin e Softuerit të Lirë dhe me Kod Burimor të Hapur (FLOSS) përpara se të ndërtojë diçka nga e para ose të blejë licenca. Për këtë qëllim, ajo do të vlerësojë projektet duke përdorur metodën e Kostos Totale të Pronësisë për një periudhë afatmesme (p.sh. 7-10 vjet) që do të përfshijë kostot e ngujimit (lock-in costs), opsionet e mirëmbajtjes etj. në koston totale të pronësisë. Autoritetet e prokurimit qeveritar gjithashtu do të kryejnë mbikëqyrje më të ashpër të përzgjedhjes duke u bazuar në markë që sipas ligjit të prokurimit është e paligjshme.

Arsyetimi dhe ndikimi i pritshëm

Kjo politikë do të çojë në procedura më konkurruese të prokurimit si në fillim të prokurimit ashtu edhe në kostot vijuese përtej periudhës 3-vjeçare të kontraktimit të lejuar nga Ligji i Prokurimit. Kjo do të zvogëlojë kostot pasi projektet e softuerit do të miratohen dhe do të ndërtohen nga kodi ekzistues me burim të hapur.

Për më tepër, kjo do të ndihmojë ekonominë lokale dhe cilësinë e shërbimeve pasi softueri FLOSS i nivelit global i ndërtuar nga firmat me përvojë shumë vjeçare të cilat tashmë kanë kontribuar në projekte që janë të gatshme për t'u adoptuar dhe përshtatur. Për më tepër, këto projekte ka më shumë të ngjarë të jenë testuar për çështje të sigurisë kibernetike, besueshmërisë dhe të respektojnë standardet e hapura. Edhe nëse furnizuesit e tanishëm kombëtarë nuk janë në gjendje të ofrojnë shërbime rreth atyre projekteve softuerike, ata do të jenë në gjendje të bëhen gati dhe t'i fitojnë ato kontrata në të ardhmen pasi që kodi do të jetë i hapur dhe i disponueshëm në çdo kohë. Për më tepër, njësitë e administratës publike, veçanërisht ato të fragmentuara si qeveritë lokale, do të jenë në gjendje të ndërtojnë aplikacione një herë dhe t'i ndajnë ato me njëri-tjetrin. Kjo do të çojë në vlerë më të mirë për paratë e taksapaguesve, disponueshmëri të programeve me cilësi më të lartë, specializim të firmave lokale të softuerit, krijim të vendeve të punës dhe zhvillim ekonomik.

Kostoja dhe afati kohor

Kursime të konsiderueshme. Udhëzuesi do të marrë disa muaj për t'u hartuar dhe vënë në fuqi.

Veprimi 3**Hapja e softuerit të ndërtuar për institucionet publike dhe publikimi në një repozitor publik****Situata aktuale**

Nuk ka politikë publike për lëshimin e kodit si softuer i lirë dhe as nuk zbatohet në praktikë.

Ndryshimi i propozuar

Përcaktimi i një politike që vendos shumicën, nëse jo të gjithë softuerin dhe kodin burimor të financuar nga paratë e qeverisë nën një licencë copyleft (që mbron të drejtën e kopjimit) të disponueshme për publikun.

Arsyetimi dhe ndikimi i pritshëm

Softueri i krijuar përmes buxhetit publik tashmë është paguar një herë nga publiku përmes taksave, prandaj duhet t'i kthehet publikut përmes një licence copyleft të softuerit siç është GPL/AGPL.

Softueri i vendosur në dispozicion do të jetë i disponueshëm për të tjerët për të punuar dhe përmirësuar atë në të ardhmen, përfshirë njësine e administratës që e prokuron atë, dhe nëse të tjerët vendosin ta përmirësojnë atë, ai mund të kthehet tek Qeveria për t'u integruar dhe përmirësuar më tej përmes raporteve të defekteve në kod dhe veçorive shtesë. Kjo për më tepër do të lejojë transparencë, e cila është një kërkesë kryesore për punën e qeverisë, veçanërisht për algoritmet që marrin vendime për të drejtat dhe privilegjet e qytetarëve si siguria, kujdesi shëndetësor, shërbimet sociale dhe taksat.

Kostoja dhe afati kohor

Pa kosto. Do të zbatohet nga momenti i miratimit e tutje. Për softuerin ekzistues, do të zbatohet kur është e mundur.

Veprimi 4**Publikimi i të dhënave të krijuara nga institucionet publike si të dhëna të hapura****Situata aktuale**

Agjenci të tilla si Kadastra dhe Hidrometeorologjia prodhojnë të dhëna të rëndësishme për jetën e qytetarëve, megjithatë këto agjenci tarifojnë për të dhënat e tyre që pengonë përdorimin nga publiku dhe zhvillimin e produkteve komerciale. Fitimet nga këto produkte janë minimale - 50,000 EUR/vit në rastin e Kadastrës - që është një përqindje e vogël e buxhetit të përgjithshëm të Agjencisë. Në të njëjtën kohë, përdorimi i paligjshëm i këtyre produkteve është i përhapur.

Qeveria ka miratuar Kartën e të Dhënave të Hapura (<https://opendatacharter.net/principles/>), edhe ka instaluar një portal të të dhënave të hapura i cili po shfrytëzohet deri diku (<https://opendata.rks-gov.net>). Përveç Ligjit për të Drejtën e Autorit, Ligji Nr. 06/L-081 për Qasjen në Dokumentet Publike transponon në një farë mase Direktivën (BE) 2019/1024 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 20 Qershorit 2019 mbi të dhënat e hapura dhe ri-përdorimin e informacionit të sektorit publik.

Ndryshimi i propozuar

Të gjitha të dhënat e prodhuara ose të prokuruar nga institucionet publike të bëhen gjerësisht të disponueshme si të dhëna të hapura të vendosura në domenin publik të qasshme për shkarkim në masë dhe përmes API-ve. Për më tepër, Qeveria do të synojë të arrijë të paktën 90% në Indeksin e të Dhënave të Hapura deri në vitin 2022. Së paku të dhënat në vijim do të çlirohen si rezultat i kësaj politike: Dokumenti i Planifikimit Hapësinor i Kosovës, Dokumentet e Planifikimit Hapësinor Komunal, Ortofotot, të gjitha të dhënat e Gjeoportalit, Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës dhe Matjet Hidrometeorologjike.

Arsyetimi dhe ndikimi i pritshëm

Të dhënat e hapura çojnë në më shumë transparencë, shërbime më të mira publike për qytetarët dhe më shumë mundësi për të ndërtuar shërbime mbi to nga qytetarët, OJQ-të dhe bizneset, duke çuar në zhvillim ekonomik dhe krijim të vendeve të punës.

Kostoja dhe afati kohor

Disa dhjetëra mijëra në vit të ardhura nga tarifat nuk do të mblidhen nga qeveria. Sidoqoftë, në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, kjo do të çojë në më shumë aktivitete në sektorin privat, shërbime më shumë dhe më të mira për qytetarët, dhe më shumë transparencë.

Veprimi 5**Blerja e të drejtave të librave shkollorë dhe botimi nën një licencë të hapur****Situata aktuale**

Ministria e Arsimit e Kosovës blen libra shkollorë me kopje pasi të ketë zgjedhur tekstin përmes një procesi gjoja konkurrues. Tekstet shkollorë janë të një cilësie të ulët dhe procesi i prokurimit nuk çon në vlerën më të mirë të parasë.

Ndryshimi i propozuar

Sigurimi i të drejtave të autorit për librat shkollorë në një proces të veçantë nga procesi i prokurimit të shtypjes. Bërja e librave shkollorë të disponueshëm nën licencë "Kulturë e Lirë" (Free Culture) e cila lejon ndarjen dhe përmirësimin e mëtejshëm nga autorë të tjerë, ndërsa lejon një proces të veçantë të prokurimit për shtypjen e librave. Ministria duhet të arsyetojë sa herë që kjo nuk është e mundur.

Arsyetimi dhe ndikimi i pritshëm

Burimet e hapura arsimore (OER - p.sh. <https://www.oercommons.org>) është një mënyrë e re për të rritur bashkësinë arsimore dhe për të zvogëluar koston dhe rritur cilësinë e materialeve arsimore, përfshirë tekstet shkollorë. Më shumë autorë dhe përkthimi i librave shkollorë (OER) duhet të çojnë në libra me cilësi më të mirë duke lejuar përmirësim të vazhdueshëm, përdorimin e formateve të ndryshme si e-librat dhe kosto më të ulëta në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Ky proces kur kombinohet me një proces të ngjashëm në Shqipëri lejon zhvillimin e përbashkët të librave.

Kostoja dhe afati kohor

Fillimisht më e lartë, por më e ulët në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Veprimi 6

Adoptimi i një shpërndarje falas të Sistemit Operativ për shkollat, përfshirja e alternativave të Softuerit të Lirë në kurrikulë dhe adoptimit i pirgjeve të Softuerit të Lirë në administratën publike

Situata aktuale

Një prokurim i madh prej 12 milion EUR për 3 vjet për sistemet operative dhe softuerin e produktivitetit për administratën publike i cili kësaj here përfshiu edhe sistemin arsimor është tentuar por ka dështuar. Ligjshmëria e softuerit që përdoret në sistemin arsimor nuk është i qartë, por mund të supozojmë se një pjesë e tij vjen i instaluar paraprakisht me pajisje dhe një pjesë është instaluar në mënyrë të paligjshme. Kontratat e softuerit komercial me firmat individuale zgjerohen, ngritën në kosto dhe bëhen më vështirë për t'u mbyllur me kalimin e kohës pasi fillon efekti i ngujimit (lock-in effect).

Kurrikulat dhe librat mësimor nuk përmendin alternativat e softuerit të lirë si një mundësi, që kufizon zgjedhjen për nxënësit në ato që nuk mund t'i përballojnë ose duke i detyruar ata të përdorin softuer paligjshëm.

Ndryshimi i propozuar

Në vend të blerjes së licencave, qeveria do të investojë në një shpërndarje të sistemit operativ të lirë përshtatshëm për mjediset arsimore.

Qeveria do të miratojë një politikë që i gjithë softueri i ri të zhvillohet në pirgje (stack) me burim të hapur, të jetë i bazuar në internet dhe të funksionojë në Linux. Të gjithë sistemet e prapavijës (backend) do të zhvendosen në një pirg të hapur. Formatet e dokumenteve të ndara me publikun do të jenë në përputhje me standardet. Në periudhë afatmesme administrata publike do të fillojnë të lëviz drejt një desktopi Linux.

Qeveria gjithashtu do të miratojë një politikë e cila paraqet alternativat e FLOSS në kurrikulë.

Arsyetimi dhe ndikimi i pritshëm

Disa nga 12 milion EUR të planifikuara për licencat e softuerit do të investohen në një alternativë të softuerit me burim të lirë. Investimet do të përdoren për të krijuar vende pune lokale dhe për të mbështetur bizneset lokale. Për më tepër, një pjesë e parave do të përdoren për të përkthyer softuer dhe materiale ndihmëse, dhe për të krijuar shërbime të shkëlqyera mbështetëse dhe trajnime të cilat aktualisht mungojnë. Fillimisht, shumica e shkollave do të pajisen me instalime Linux, me boot të dyfishtë me Windows nëse ai është instaluar tashmë ligjërisht.

Kostoja dhe afati kohor

Fillimisht disa nga kostot do të zhvendosen drejt firmave lokale në investime në shërbime shtesë mbështetëse të cilat nuk ekzistojnë për momentin ndërsa në planin afatgjatë do të ketë kurse për buxhetin publik.

Veprimi 7**Politikat FLOSS****Situata aktuale**

Aktualisht nuk ka një politikë gjithëpërfshirëse qeveritare që thekson parimet FLOSS në qeveri edhe pse pjesë të saj janë zbatuar në pjesë të qeverisë por pa ndonjë drejtim strategjik ose koordinim.

Ndryshimi i propozuar

Qeveria do të përkushtojë burimet e nevojshme njerëzore, trajnuese dhe monetare për të bërë të mundur miratimin e politikave FLOSS të sugjeruara në këtë dokument, p.sh. përmes një Zyre për Programin Open Source. Qeveria do të përdorë Strategjinë Open Source të Komisionit Evropian 2020-2023*, Kornizën e Re Evropiane të Ndërveprimet**, Kartën e të Dhënave të Hapura dhe indekse të ndryshme për të drejtuar aktivitetin e saj në këtë fushë me qëllim të progresit të vazhdueshëm, duke kuptuar se këto dokumente shpesh janë emëruesit më të vegjël të përbashkët dhe FLOSS është më i favorshëm ekonomikisht për Kosovën sesa për shumë qeveri evropiane që kanë të etabluara industri të softuerit komercial.

Arsyetimi dhe ndikimi i pritshëm

Drejtimi dhe koordinimi i përgjithshëm duhet të çojë në parandalimin e investimeve të dyfishta dhe përsheptimin e zbatimit.

Kostoja dhe afati kohor

Çdo staf shtesë do të përfshijë disa kosto të cilat do të kthehen përmes një efikasiteti më të madh në zbatim.

* Communication To The Commission: Open Source Software Strategy 2020 –2023 Think Open. Brussels, 21.10.2020 C(2020) 7149 final

** New European Interoperability Framework: Promoting seamless services and data flows for European public administrations
https://ec.europa.eu/isa2/sites/isa/files/eif_brochure_final.pdf



Për FLOSSK - un

Free Libre Open Source Software Kosova (FLOSSK) është një organizatë joqeveritare e bazuar në Prishtinë e themeluar në vitin 2009 me qëllim që të mbështesë, promovojë dhe zhvillojë softuerin e lirë me kod burimor të hapur, dijen e hapur dhe pjesëmarrëse, edukimin në teknologjitë e informacionit përmes lëndëve të hapura, dhe standardet, kulturën dhe shoqërinë e hapur duke përdorur komunikimin e lirë.

Projektet më të rëndësishme të FLOSSK janë konferenca ndërkombëtare e softuerit të lirë Software Freedom Kosova (SFK) dhe hapësira për eksperimentim në teknologji, art dhe kulturë Prishtina Hackerspace. FLOSSK synon të rinjtë, studentët dhe profesionistët e IT-së.

Propozimet e FLOSSK për Qeverinë në lidhje me politikat Open Source

Mars 2021

KONTAKTI

FLOSSK
c/o Prishtina Hackerspace
Ganimete Tërbeshi nr 61
Aktash
Prishtinë, Kosovë 10000
+383 44 233 967
info@flossk.org

Na gjeni në:

Matrix: [#flossk:matrix.org](https://matrix.org/#flossk:matrix.org)
IRC: [#flossk@freenode](https://freenode.net/#flossk)
Twitter: [@flosskosova](https://twitter.com/flosskosova)
Telegram: <https://t.me/openflossk>
Mastodon: [@flossk@mastodon.cloud](https://mastodon.cloud/@flossk)
Facebook: [@flossk](https://www.facebook.com/flossk)
Instagram: [@flosskosova](https://www.instagram.com/flosskosova)

Licenca:
<http://creativecommons.org/licenses/by/4.0>

Pregatitur nga anëtarët dhe miqtë e FLOSSK-ut

